

PASA: Sistemi Alternativ i Vlerësimit i Pensilvanisë

Çfarë është PASA?

Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara (IDEA) i vitit 2004 kërkon që shtetet dhe Agjencitë Arsimore Lokale (Local Education Agencies, LEA) të sigurohen që fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshihen në të gjitha programet e përgjithshëm të vlerësimit shtetëror dhe të mbarë qarkut shkollor. Sistemi Alternativ i Vlerësimit i Pensilvanisë (PASA) është zhvilluar në përputhje me këtë, me qëllim që të përmbushen nevojat e personave

Çfarë kuptimi kanë **Emerging, Approaching Target, At Target** ose **Advanced (Në zhvillim, Duke iu afruar objektivit, Në objektiv ose I avancuar)**?

Nivelet e performancës përkufizohen si më poshtë:

- **Emerging (Në zhvillim):** Studenti është duke u zhvilluar në aftësitë për të kuptuar dhe për të vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë e përfaqësuara nga Essential Elements.
- **Approaching Target (Duke iu afruar objektivit):** Aftësitë studentit për të kuptuar dhe për të vënë në zbatim njohuritë e synuara dhe aftësitë e përfaqësuara nga Essential Elements janë duke iu afruar objektivit.
- **At Target (Në objektiv):** Aftësitë e studentit për të kuptuar dhe vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë e përfaqësuara nga Essential Elements kanë arritur objektivin.
- **Advanced (I avancuar):** Studenti ka aftësi të avancuara për të kuptuar dhe vënë në zbatim njohuritë dhe aftësitë e përfaqësuara nga [ELA](#), [Matematika](#) dhe [Shkenca](#) Essential Elements.

që kanë më tepër aftësi të kufizuara konjitive, të cilët nuk mund të marrin pjesë në vlerësimin e përgjithshëm edhe nëse u sigurohen akomodime. Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë bashkëpunon me [Dynamic Learning Maps](#) për të zhvilluar versionin më të fundit të PASA.

Çfarë merr parasysh PASA?

Me anë të kryerjes së detyrave, PASA sheh se sa njohuri dhe aftësi kanë fituar fëmijët që kanë aftësi të kufizuara të konsiderueshme konjitive. Ky vlerësim është në përputhje me standardet akademike të Pensilvanisë, me reduktim në thellësi dhe gjerësi. Ngjashëm me testin e standardizuar mbarë-shtetëror (Sistemi i Vlerësimit i Pensilvanisë ose PSSA), qëllimi i PASA është t'u japë informacion rrethëve shkollore dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve arsimore për t'i ndihmuar në përmirësimin e mësimdhënies për fëmijët. PASA zhvillohet në klasat 3-8 dhe 11 si në ELA, ashtu edhe në Matematikë, dhe në klasat 5, 8 dhe 11 në Shkencë. **Për të parë me hollësi se çfarë trajtohet në provimet e PASA në ELA, Matematikë dhe Shkencë, shikoni [dokumentet e projektit](#) për çdo lëndë.**

Si përcaktohet nëse dikush pranohet për PASA?

Ky vendim merret nga stafi i IEP në shkollën e fëmijës suaj. Stafi i IEP përdor [PASA Eligibility Criteria Companion Tool](#) për të përcaktuar nëse studentët i plotësojnë të gjashta kërkesat. Stafi i IEP duhet t'u përgjigjet po të gjashta kriterëve në mënyrë që fëmija juaj të marrë pjesë në PASA.

Kur do të marrë pjesë në PASA fëmija im?

PASA zhvillohet çdo vit, dhe periudhat e testimit zakonisht janë në muajt e pranverës mars, prill dhe maj. Duhet të shikoni [Kalendarin e SDP për Vlerësimet](#) si edhe kalendarin e shkollës të fëmijës suaj për datat specifike se kur do të zhvillohet PASA në shkollën e tij ose të saj.

Çfarë bëjnë mësuesit me rezultatet e PASA të fëmijës tim?

Rezultatet individuale të studentëve, të cilat i jepen vetëm shkollës të fëmijës tuaj, mund të përdoren për të ndihmuar mësuesit të dallojnë cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës suaj. Kjo më pas u jep mundësi mësuesve ta përshtatin mësimdhënien për fëmijën tuaj në mënyrë që ta ndihmojnë të zhvillohet më tej. Rezultatet e PASA u sigurojnë gjithashtu informacion shkollave dhe qarqeve, i cili mund të ndihmojë në përmirësimin dhe planifikimin e diskutimeve për planin mësimor dhe mësimdhënien.

Cilat lloje rezultatesh raportohen në PASA?

Raporti për rezultatin e çdo studenti përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e raportit të rezultatit është Profili i Performancës, i cili jep informacion të gjerë lidhur me atë çka studenti di dhe mund të bëjë në përgjithësi në lëndë. Pjesa e dytë e raportit të rezultatit është Profili i të Mësuarit, i cili jep informacion specifik për aftësitë që studenti ka përvetësuar. Për informacion të mëtejshëm lidhur me këtë temë, mund të shikoni [Udhëzuesin e PASA për Rezultatit](#).

A është PASA me kohë?

PASA nuk është me kohë, megjithatë studentët nuk mund plotësojnë një seksion - të quajtur gjithashtu "testlet" - për më shumë se një ditë. Për shembull, nëse një student e fillon një testlet të hënën, ai nuk mund ta përfundojë testletin të martën.

A ndikon PASA te notat e fëmijës tim?

Ky test nuk ndikon te notat e studentëve.

Si mund të marrë pjesë fëmija im në PASA?

PASA zhvillohet me anë të kompjuterit; megjithatë studentët duhet të jenë të pranishëm fizikisht në shkollë për testin.

Ku mund t'i gjejë rezultatet nga PASA?

Shkollat marrin kopje të Raporteve të Studentëve çdo vit disa muaj pasi mbyllet periudha e testimit. Mund t'i kërkonit shkollës së fëmijës suaj një kopje të Raportit të Studentit. Rezultatet postohen gjithashtu në një Portal për Prindërit te pjesa Testi Standard te Profili i Studentit.

Kë mund të kontaktoj nëse kam pyetje të mëtejshme për PASA?

Nëse keni pyetje të mëtejshme rreth PASA, rekomandohet që të kontaktoni shkollën e fëmijës suaj. Informacionet e kontaktit për shkollën e fëmijës suaj mund të merren nga [faqja e internetit e Profileve të Shkollës](#) e SDP.

Ku mund të gjej më shumë informacion për PASA?

Zyra e Vlerësimeve e Rrethit Shkollor të Filadelfias:
<https://www.philasd.org/research/#assessmentsera>

Dynamic Learning Maps (Ofrues i PASA): <https://dynamiclearningmaps.org/pennsylvania>

Faqja e internetit e PASA të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë:
<https://www.pa.gov/agencies/education/programs-and-services/instruction/elementary-and-secondary-education/assessment-and-accountability/pennsylvania-alternate-system-of-assessment-pasa.html>